



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 699/ 6 prot

Datë 17.03.2026

V E N D I M

Nr. 398 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-72218-12-15-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike dhe printera për nevojat e Bashkisë Kukës dhe Njësive Administrative”, me fond limit: 5,000,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Introvus Solutions” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-72218-12-15-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike dhe printera për nevojat e Bashkisë Kukës dhe Njësive Administrative”, me fond limit: 5,000,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Telia Kurti” P.F, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “INSTANT.AL” ShPK, me Nipt L81506043D. Adresa: Rr. Ali Demi, Z. kadastrale 8150, Nr i pasurise 8/801, Tiranë.

Operatori ekonomik "Introvus Solutions" SHPK, me NIPT L91323013Q dhe adresë: Rr "e Kavajës", Hyrja -1, Nr pasurie 4/245-N24, perballe Poliambulancës, Tiranë

Subjekte të Interesuar

Operatori ekonomik "Telia Kurti" P.F me NIPT M12409002V dhe adresë: Nj. Adm Nr.9, Rr."Sulejman Vathi", Nd. Nr.18, Tiranë.

Operatori ekonomik "Optima Communication" SHPK me NIPT K71903025A, adresa: Rr. Shyqyri Berxolli, Pallati Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6-të, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kukës.
Adresa: Sheshi Skënderbej, Lagjja Nr.5, Kukës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi pretendimet të ngritura në ankesa, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

1.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 16.12.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-72218-12-15-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike dhe printera për nevojat e Bashkisë Kukës dhe Njësive Administrative”, me fond limit: 5,000,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

II.2. Në datë 09.12.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik rezulton, se në datën 16.02.2026, është kryer vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

1. INSTANT.AL ShPK	me ofertë	2,629,800 Lekë pa TVSh	Kualifikuar
2. Introvus Solutions ShPK	“	2,997,000	Kualifikuar
3. OPTIMA COMMUNICATION ShPK	“	3,099,000	Kualifikuar
4. Advanced Business Solutions – ABS ShPK		3,324,750	Kualifikuar
5. PC STORE ShPK	“	3,376,000	Kualifikuar
6. ELECTRON ALBANIA 2008 ShPK	“	3,604,000	Kualifikuar
7. SINTEZA CO ShPK	“	4,103,400	Kualifikuar
8. BNT ELECTRONICS ShPK	“	4,250,400	Kualifikuar
9. TELIA KURTI P.F	“	4,805,000	Kualifikuar
10.IT Gjergji Kompjuter SHPK	pa ofertë ekonomike		Skualifikuar

II.3.1.Në datën 24.02.2026, është kryer rivlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë:

1. INSTANT.AL ShPK	me ofertë	2,629,800 Lekë pa TVSh	SKualifikuar
2. Introvus Solutions ShPK	“	2,997,000	Skualifikuar
3. OPTIMA COMMUNICATION ShPK	“	3,099,000	Kualifikuar
4. Advanced Business Solutions – ABS ShPK		3,324,750	Kualifikuar
5. PC STORE ShPK	“	3,376,000	Kualifikuar
6. ELECTRON ALBANIA 2008 ShPK	“	3,604,000	Kualifikuar
7. SINTEZA CO ShPK	“	4,103,400	Kualifikuar
8. BNT ELECTRONICS ShPK	“	4,250,400	Kualifikuar
9. TELIA KURTI P.F	“	4,805,000	Kualifikuar
10.IT Gjergji Kompjuter SHPK	pa ofertë ekonomike		Skualifikuar

II.4. Në datën 03.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesi paraparak në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.5. Njëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6386, datë 04.03.2026 dhe me Nr. 699/2026 Prot., date 04.03.2026 e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” ShPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr.

REF-72218-12-15-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike dhe printera për nevojat e Bashkisë Kukës dhe Njësi Administrative”, me fond limit: 5,000,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “INSTANT.AL” ShPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 699/1 prot., datë 05.03.2026, lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ, në përputhje me nenin 113 të LPP-së, rezulton se në sistemin e ankesave elektronike është dorëzuar Formulari i argumenteve , protokolluar me nr.699/2, date 10.03.2026, nga operatori ekonomik të interesuar “OPTIMA COMMUNICATION” ShPK, mbi kundërshtimin e ankesës me pretendim se operatori ekonomik “INSTANT.AL” ShPK, është skualifikuar me të drejtë për ofertë anomalisht të ulët

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. Nr.1159 prot.,datë 10.03.2026, protokolluar me tonën me Nr. 699/3, datë 12.03.2026, autoriteti kontraktor ka paraqitur “Informacion” pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Vendimin me Nr. 15, datë 10.03.2026 të KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës, duke vendosur mospranim të pretendimeve të paraqitura nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK.

II.9. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, është dorëzuar ankesa me numër aplikimi A/2026/6394, datë 05.03.2026 dhe me nr. 721/2026 prot., datë 06.03.2026 i operatorit ekonomik “Introvis Solutions” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” me Nr. REF-72218-12-15-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike dhe printera për nevojat e Bashkisë Kukës dhe Njësi Administrative”, me fond limit: 5,000,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues “Introvis Solutions” ShPK nga procedura e prokurimit sipërcituar, si edhe kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Telia Kurti” P.F.

II.10. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 721/1 prot., datë 09.03.2026, lidhur me pretendimet e ankimuesit.

II.11. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ, në përputhje me nenin 113 të LPP-së, rezulton se në sistemin e ankesave elektronike është dorëzuar Formulari i argumenteve , protokolluar me nr.721/2, date 11.03.2026, nga operatori ekonomik të interesuar "OPTIMA COMMUNICATION" ShPK, mbi kundërshtimin e ankesës së operatorit ekonomik "Introvus Solutions" ShPK me pretendim se është skualifikuar me të drejtë për ofertë anomalisht të ulët.

II.12. Nëpërmjet shkresës nr. Nr.353/13 prot.,datë 12.03.2026, protokolluar me tonën me Nr. 721/3, datë 12.03.2026, autoriteti kontraktor ka paraqitur "Informacion" pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Vendimin me Nr. 14, datë 10.03.2026 të KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke vendosur mospranim të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik "Introvus Solutions" ShPK.

II.13. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimeve administrative, në përputhje me nenin 113 të LPP-së, rezulton se në sistemin e ankesave elektronike nuk janë dorëzuar argumente nga operatorë ekonomikë të tjerë të interesuar për procedurën objekt shqyrtim.

III

Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik "**Introvus Solutions**" SHPK për shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij si ofertë anomalisht e ulët,

*si rezultat i vlerësimit të gabuar të operatorit ekonomik "Telia Kurti" P.F për mospërbushjen e kriterëve të të kualifikimit 2.3 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim 2.3.5 Operatori ekonomik duhet te deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar duke përfshirë montimin, instalimin, konfigurimin e mallrave të lëvruara. Oferta jone eshte skualifikuar me arsyetimin Oferte anomalisht e ulet ne baze te nenit 82 vkm 285 date 19.05.2021 Per Miratimine Rregullave te Prokurimit Publik (i ndryshuar) . Me date 03.03.2026 jemi njoftuar ne sistemin e APP-se, per fillimin e afateve te ankimimit. ... Kompania jone operon prej vitesh ne tregun vendas dhe te huaj dhe jemi operator ekonomik aktiv ne procedurat e prokurimit publik si dhe ato private dhe nga eksperienca jone, **na lindin dyshime te arsyeshme mbi kualifikimin e operatoreve te tjeter ekonomike ne kete procedure.** Ne klasifikimin e operatoreve ekonomik pjesemarres nder te tjeret eshte edhe operatori Telia Kurti ku nga te dhenat ne Njoftimin e Fituesit te publikuar 10. TELIA KURTI P.F - Vlera:4,805,000 leke pa Tvsh. OE/BOE me nenkontraktor JO x, si dhe nga verifikimi ne faqen zyrtare te QKB-se, verehet se eshte person fizik dhe nuk ka as nenkontraktor te deklaruar. Referuar DST Autoriteti nder te tjera ka kerkuar qe pervec levrimet te mallrave duhet te realizohet edhe montimi, instalimi dhe konfigurimi i tyre ne cdo post pune*

Per arsyet e mesiperme, nepermjet kesaj ankese kerkojme gjithashtu te rivleresoni ofertat e operatoreve te tjeter ekonomik nese ato jane ne perputhje te plote me kerkesat e tenderit. Referuar legjislacionit te prokurimit publik Autoriteti/enti kontraktor eshte pergjegjes per menaxhimin e fondeve publike te percaktuara per perdorim ne prokurimet publike, ne perputhje

me dispozitat e ligjit nr.162/2020, Per prokurimin publik dhe udhezimeve te Agjencise se Prokurimit Publik, te dala ne baze dhe per zbatim te LPP-se. Skualifikimi i padrejte i ofertes tone sjell nje difference midis ofertes tone dhe operatorit ekonomik te shpallur fitues prej 102.000 lek, te cilat do shkaktojne nje dem ekonomik buxhetit te Autoritetit.

III.1.1 Autoriteti kontraktor ka publikuar në DST Shtojca 8, Formulari i Kritereve për kualifikim, Kriteri 2.3.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që merr përsipër transportin e pajisjeve pranë ambjenteve të Autoritetit Kontraktor brenda afatit të parashikuar duke përfshirë montimin, instalimin, konfigurimin e mallrave të lëvruara.

III.1.2. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

III.1.3. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa dhe përsa kohë janë pranuar prej tyre.

III.1.4. Nisur nga pretendimet e ngritura në ankesë Komisioni mori në shqyrtim dokumentet e ofertës depozituar në SPE të operatorit ekonomik “Telia Kurti” P.F. dhe konstatoi se:


Në përmbushje të kriterit kualifikues 2.3.5, të shtojcës 8, operatori ekonomik ka hedhur



dokumentin

Deklaratat_Telia_Kurti_PF_compressed.pdf

ku në brendi të të cilit gjendet:



Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik "Telia Kurti" P.F ka paraqitur Deklaratën në përmbushje të kriterit 2.3.5 e cila rezulton e rregullt në përmbajtje, e firmosur dhe vulosur nga administratori i operatorit ekonomik.

Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimuese ngre pretendime të pabazuara dhe të hamendësuara mbi operatorin ekonomik Telia Kurti P.F, pretendime të cilat nga konstatimet e kryera rezultojnë të pabazuara në fakte dhe prova. Përsa më sipër Komisioni gjykon se:

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Gjithashtu nga shqyrtimi i mësipërm Komisioni gjykon se gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik "Telia Kurti" P.F do të vijojë të ngelet e kualifikuar duke mosndryshuar rezultatet e vlerësimit të kryer nga KVO, mbi ofertat e sukseshme në procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

III.2. Në lidhje me pretendimet e operatorëve ekonomikë ankimues “INSTANT.AL” ShPK, dhe “Introvus Solutions” SHPK, mbi kundërshtimin e arsyeve së skualifikimit si vijon:

Arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik “INSTANT.AL” ShPK:

Oferte anomalisht e ulet ne baze te nenit 82 VKM 285 datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK(i ndryshuar).

Me pretendime në mënyrë të përmbledhur:

Autoriteti Kontraktor ka kryer dy veprime procedurale te papajtueshme: 1 me 16.02.2026 e konsideron operatorin ekonomik INSTANT.AL si ofertues te renditur te parin;

Me shkresën kerkese per dorezim dokumente me dt 16.02.2026 kemi marre njoftim.

Me pas me dt 24.02.2026 njoftohemi per skualifikim te ofertes sone si anomalisht te ulet. Keto dy veprime jane juridikisht kontradiktore, pasi analiza e ofertes anomalisht te ulet duhet te zhvillohet perpara renditjes perfundimtare te ofertave.

Kemi dyshime se disa operateore ekonomike nuk plotesojnë kriteret kualifikuese dhe kërkojmë vlerësim të ofertave. AK te analizoje elementet e ofertes dhe te kerkoje shpjegime. Kerkojme te kualifikohemi.

Këto dy veprime janë juridikisht kontradiktore,

Arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik “Introvus Solutions” SHPK

[...]Oferte anomalisht e ulet ne baze te nenit 82 VKM 285 datë 19.5.2021 PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK(i ndryshuar)

[...] Referuar te drejtes se dhene nga legjislacioni i prokurimit publik me ane te kesaj ankese kundërshtojme vendimet e Autoritetit Kontraktor per skualifikimin e ofertes tone. Referuar Nenit 82 te VKM 285 i cili shprehet Komisioni i vleresimit te ofertave verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe permbushin kerkesat per kualifikim, te percaktuara ne dokumentet e tenderit

Skualifikimi i padrejte i ofertes tone sjell nje difference midis ofertes tone dhe operatorit ekonomik te shpallur fitues prej 102.000 lek, te cilat do shkaktojne nje dem ekonomik buxhetit te Autoritetit. [...]

III.2.1. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik rezulton, se në datën 16.02.2026 është kryer vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe me datë 23.02.2026 Autoriteti kontraktor ka rivlesuar ofertat duke skualifikuar operatorët ekonomikë ankimues për oferta anomalisht të ulëta.

Me date 03.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesi paraprak në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, datë pasillojnë afatet e ankimit për operatorët ekonomikë.

Operatorët ekonomikë kanë depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6386, datë 04.03.2026 dhe me Nr. 699/2026 Prot., date 04.03.2026 e operatorit ekonomik INSTANT AL ShPK dhe ankimimi elektronik A/2026/6394, datë 05.03.2026 dhe me nr. 721/2026 prot., datë 06.03.2026 i operatorit ekonomik “Introvus Solutions” SHPK, lidhur me pretendimet mbi kundërshtuar arsyet e skualifikimit në procedurën sipërcituar.

III.2.2 Në pikën 1 dhe 7 të nenit 34 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se:

1. Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysh kur përlllogarit vlerën e prokurimit.

7. Kur një punë, mall ose një shërbim mund të rezultojë në dhënien e disa kontratave në formën e loteve të veçanta, duhet të merret parasysh vlera e përgjithshme e të gjitha këtyre loteve.”

III.2.3. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.*

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

III.2.4. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;*

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.
- Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPPsë.
- Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.2.5. Në Kreun II “Kufijtë monetarë në sektorin klasik” të VKM-së nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, përcaktohet se:

“1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë ; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i ofertave ekonomike të operatorëve si edhe informacionit të dosjes vëren se operatorët ekonomikë ankimues “INSTANT.AL” ShPK dhe “Introvus Solutions” SHPK kanë ofertuar me vlerat si vijon:

- INSTANT.AL ShPK me ofertë 2,629,800 Lekë pa TVSh dhe
- Introvus Solutions ShPK me ofertë 2,997,000 Lekë pa TVSh

dhee Autoriteti kontraktor nga përlllogaritjet e kryera, ka konstatuar se ofertat e tyre ekonomike janë me vlera anomalisht të ulëta në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara dhe aplikimit të formulës përkatëse.

Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i ankesave vëren gjithashtu se ankimuesi INSTANT.AL ShPK pretendon se, Në arsyen e skualifikimit AK nuk ka dhënë shpjegimet mbi analizë ekonomike të ofertës; krahasim të çmimeve të tregut; analizë të strukturës së kostos, mbi argumentimin e ars skualifikimit të operatorit ekonomik për ofertën anomalisht të ulët, në rastin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

Referuar të dhënave mbi procedurën e prokurimit publikuar në SPE, Komisioni konstaton, se referuar urdhrin të prokurimit që daton më 09.02.2025, periudhë në të cilën Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” ka pësuar ndryshime me Ligjin 16/2024, datë 08.02.2024. Referuar Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në zbatim të pikës 5 të nenit 93 të LPP-së është përcaktuar se: në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është onstatuar anomalisht e ulët”, procedura e prokurimit objekt-shqyrtimi “Blerje paisje kompjuterike dhe printera për nevojat e Bashkisë Kukës dhe Njësisë Administrative”, me fond limit:5,000,000 Lekë pa TVSH, rezulton më vlerë të fondit limit nën kufirin e ulët monetar,

referuar VKM-së Nr. 291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, kreu II pika 1 ku përcaktohet se: 1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë. Konkretisht ndryshimet në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kanë hyrë në fuqi pas datës 20.03.2024, ndërkohë që Urdhri i prokurimit, për procedurën e mësipërme mban datën 09.02.2025, për procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e ulët monetarë, siç është rasti në fjalë, autoriteti kontraktor, në përputhje me nenin 93, pika 5, e LPP-së (5.Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”) e refuzon ofertën e cila është konstatuar anomalisht e ulët, pa kërkuar shpjegime.

Gjithashtu Komisioni, referuar dosjes administrative vëren se KVO me veprimet mbi vlerësimin e ofertave me datë 16.02.2026 dhe rivlerësim me date 24.02.2026 datë në të cilën ka konstatuar dy oferta anomalisht të ulëta në zbatim të formulës përkatëse, nuk ka kryer shkelje procedurale pasi nuk ka cënuar interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë, akoma më tej AK ka shpallur njoftim paraprak të fituesit më datë 03.03.2026.

Autoriteti kontraktor për skualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë ankimues, “INSTANT.AL” ShPK dhe “Introvus Solutions” SHPK të cilat në aplikim të formulës rezultuan anomalisht e ulëta, ka krye vlerësimin në zbatim të parashikimeve të nenit 93 të LPP-së i ndryshuar, duke skualifikuar operatorët ekonomikë ankimues pa i kërkuar shpjegime.

Komisioni i Prokurimit Publik referuar pretendimeve të ankimuesve, mori në shqyrtimi ofertat e operatorëve ekonomikë “INSTANT.AL” ShPK dhe “Introvus Solutions” SHPK, si edhe nga përllogaritjet e kryera, konstaton, se ofertat ekonomike në vlera prej: 2,629,800 L pa TVSh dhe 2,997,000 L pa TVSH, në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezultojnë anomalisht e ulëta, bazuar kjo në Formulën $MO/Nr.O-32,189,355/9 = 3,576,594,^{44} \times 85\% = 3,040,105.^{28}$, dhe ofertat nën këtë vlerë vlerësohen anomalisht të ulëta.

Përsa analizuar më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, pretendimet e ngritura në ankesat e operatorëve ekonomikë “INSTANT.AL” ShPK dhe “Introvus Solutions” SHPK, nuk qëndrojnë pasi ofertat e tyre rezultojnë të jenë në vlera anomalisht e ulëta, dhe vendimi i KVO-së mbi vlerësimin e kryer është i drejtë dhe qëndron në fuqi.

Pretendimet e operatorëve ekonomikë “INSTANT.AL” ShPK dhe “Introvus Solutions” SHPK nuk qëndrojnë

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative

për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-72218-12-15-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike dhe printera për nevojat e Bashkisë Kukës dhe Njësive Administrative”, me fond limit: 5,000,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.
 2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Introvus Solutions” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-72218-12-15-2025, me objekt “Blerje paisje kompjuterike dhe printera për nevojat e Bashkisë Kukës dhe Njësive Administrative”, me fond limit: 5,000,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 09.02.2026 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kukës.
 3. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapa të mëtejshëm procedurën e prokurimit objekt shqyrtim.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatorët ekonomikë “INSTANT.AL” ShPK dhe “Introvus Solutions” ShPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Nënkryetar

Fiorent Zguro

